



Nr. 1201 Prot.

Tiranë, më 8.2.2021

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVË

Nr. 9 Datë 8 2 2021

**PËR
MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE TË SHOQËRISË ;
“ TIPOGRAFIA USHTARAKE SHA TIRANË NGA
“SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË” SHA TIRANË**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ” i ndryshuar, statutit të shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sha Tiranë dhe statutit të shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sha Tiranë, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërive;

VENDOSA:

1. Miratimin e Marrëveshjes së Bashkimit me Përthithje të shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sha Tiranë nga shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sha Tiranë.
2. Kapitali i shoqërisë përthithëse “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sha Tiranë, bëhet 420.663.000 lekë, i përbërë nga 420,663 aksione me vlerë nominale 1000 leke secila.
3. Shoqëria “Tipografia Ushtarake” sha Tiranë, pas përfundimit të bashkimit, vlerësohet e prishur, sipas nenit 220 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2014 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ndaj çregjistrohet nga QKB, sipas seksionit V të Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për regjistrimin e biznesit”.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


MINISTËR
Anila DENAJ

